


RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në “Ekonomiks”
Ofruar nga Universiteti Epoka

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:
Prof. Asc Dr. Brunilda Duraj



(Qershor/2017)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSC në "Ekonomiks"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Epoka
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative
3	Urdhëri/VKM i licencimit	VKM Nr. 281, datë 12.03.2008
	Urdhëri i riorganizimit	Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 260, datë 07.06.2011 (*)
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Ekonomiks
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Aktivizimi i programit të studimit	2012-2013
17	Numri i studentëve për program studimi	110

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

* Sipas Urdhërit të Akreditimit Nr. 260, datë 07.06.2011, ky program studimi është akredituar si; Bachelor në Ekonomik **me kohëzgjatje normale 4 vite**. Eshtë hera e parë që ky program studimi i nënshtrohet procesit të akreditimit pas riorganizimit të tij me Urdhër Nr. 312, date 27.07.2012, si Bsc në Ekonomiks me kohëzgjatje normale 3 vite.



HYRJE

Ky raport përmban gjetjet e vlerësimit të jashtëm të kryer në kuadrin e kërkesës së Universitetit Epoka për akreditimin periodik të programit të studimit “Bachelor në Ekonomiks”.

Universiteti Epoka është një Institucion i Arsimit të Lartë Privat i krijuar në bazë të Ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.156, datë 22.03.2001, “Për shkollat jo-publike në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.281, datë 12.03.2008 “Për licensimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë, shkolla e lartë Epoka”

IAL e ka filluar aktivitetin mësimor gjatë vitit akademik 2008-2009 dhe ofron programe studimi të ciklit të parë të studimeve (Bachelor), ciklit të dytë të studimeve (Master I Shkencave dhe Master Profesional) dhe të ciklit të tretë të studimeve (Doktoraturë).

Departamenti i Ekonomiksit në Universitetin “Epoka”, është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative dhe është njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e këtij Programi Studimi. Ai vepron si njësi bazë mësimore - kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e Ekonomiksit.

Programi i ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në Ekonomiks është i akredituar me Urdhërin Nr. 260, datë 07.06.2011 si bachelor në Ekonomik me **kohëzgjatje normale 4 vite**.

Me Urdhërin e Ministrit me Nr. 312, datë 27.7.2012 për “Riorganizimin e programeve të studimit të Institucionit privat të Arsimit të Lartë”, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit, VKA Nr. 342, datë 13.07.2012 për “Riorganizimin e programeve të studimit të Institucionit privat të Arsimit të Lartë, “Shkolla e lartë “Epoka”, **riorganizon** programin e studimit (Ekonomiks) të ciklit të parë (DNP) me kohëzgjatje normale 4 vite akademike, në “Bachelor” që realizohen me 180 kredite Europiane (ECTS) dhe me kohëzgjatje 3 vite akademike.

Për programin e riorganizuar **Bsc Ekonomiks (3 vite)** nuk ka urdher akreditimi. Diploma “Bachelor në Ekonomiks”, me të cilën pajisen studentët pasi kanë përfunduar me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara nga ky program, 180 kredite europiane e lëshuar pas riorganizimit të programit të studimit, mbështetet në programin 4 vjecar të studimit të akredituar me Urdhërin Nr. 260, datë 07.06.2011.



Universiteti Epoka, ka sjellë në ASCAL me shkresë Nr. 020/6 prot, datë 23.06.2017 “ Kthim përgjigje në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të programit të studimit Bachelor në “Ekonomiks”, ku njofton se Institucioni nuk ka komente mbi Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Prof Asc. Dr. Brunilda Duraj

Gjatë gjithë procedurës, ekspertja e jashtme e vlerësimit është asistuar nga specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e dhëna në VKA Nr. 176, datë 30.05.2011 nga Këshilli i Akreditimit

- a) Të harmonizohet më mirë sistemi i zbatuar Amerikan me atë European në kuadrin e procesit të Bolonjës
- b) Të zgjerohet literatura e bibliotekës dhe të rritet numri i librave në bibliotekë
- c) Të nxitet më mirë puna individuale nga studentët gjatë zhvillimit të procesit mësimor duke iu dhënë prioritet orëve të vecanta të seminareve, prezantimeve me goje, eseve të ndryshme, projekteve individuale dhe në grup, etj.
- d) Të ketë një specializim më të qartë të stafit akademik në fusha të caktuara, në mënyrë që të rritet niveli i mësimdhënies.
- e) Të koordinohet më mirë koha e qëndrimit të profesorëve në mënyrë që të mos krijohet mbingarkesa mësimore, e cila krijon vështirësi për studentët.
- f) Të organizohet më mirë orari dhe ngarkesa mësimore nga profesorë të huaj
- g) Të rritet numri i stafit akademik të kualifikuar të cilët janë të punësuar.
- h) Të përgatitetn programe të plota të kërkimit shkencor dhe të rritet pjesëmarrja në projekte kërkimore që shërbejnë për ekonominë Shqiptare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin e parë lidhur me harmonizimin e Sistemit Amerikan me atë European, Institucioni ka riorganizuar programin 4 vjeçar (Sistem

Amerikan) mështetur në Urdhërat e MAS (Urdhëri nr. 312, datë 27.07.2012) në programet e studimit “Bachelor” 180 ETSC me kohëzgjatje 3 vite akademike Ky Urdhër nuk përmban ndonjë dispozitë që kërkon ri-akreditimin e programit të studimit.

Në planet mësimore janë paraqitur lëndët edhe sipas krediteve (Epoka credits) dhe sipas ECTS-ve. Gjithashtu janë bërë ndryshime në syllabus-et e lëndeve, ku janë pasqyruar në mënyre të detajuar mënyra e vlerësimit të studentit, ku përfshihen projekte në grup apo punë të pavarura të studentëve.

Ky rekomandim është plotësuar.

- b) Për rekomandimin lidhur me shtimin e librave dhe literaturës në bibliotekë, institucioni ka rritur numrin e librave në bibliotekë ku numri i librave dhe dokumentave të printura ka arritur në 7000 libra, e dhënë e konfirmuar dhe nga vizita GVJ në bibliotekën e Universitetit “Epoka”, si dhe ofron Librarinë Dixhitale, ku nëpërmjet katalogut dixhital të librave, akseson libra elektronik në fusha të ndryshme studimi. Librat janë në gjuhë të ndryshme: shqip, anglisht, turqisht, etj. Gjithashtu, Institucioni u ka krijuar mundësi dhe akses studentëve në bibliotekat online si JSTORE, EBSCOHOST, ku në ambientet e bibliotekës aksesimi ishte i hapur për të gjithë (pa kod hyrje), ku studentët, pedagogët dhe përdoruesit e bibliotekës mund të aksesojnë burime elektronike me tekst të plotë pa pagesë. GVJ provoi përdorimin e këtyre bibliotekave. Gjithashtu Institucioni është abonuar dhe në revista vendase si revista “Monitor”.

Ky rekomandim është plotësuar.

- c) Për rekomandimin të nxitet më mirë puna individuale nga studentët gjatë zhvillimit të procesit mësimor, institucioni ka riparë programet mësimore dhe syllabus-et. Në syllabuse është parashikuar një standard vlerësimi në notën përfundimtare në raportin 60 % nga kontributi i studimeve gjatë semestrit dhe 40 % provimi përfundimtar. Në vlerësimin nga kontributi i studimeve gjatë semestrit, pedagogu vlerëson në masën 10% ndjekjen dhe pjesëmarrjen aktive në lëndë, 20% plotësimin e detyrave ku pedagogu i lëndës ka liri akademike të përcaktojë numrin e projekteve, kuizeve, ushtrimeve, detyrave të kursit në varësi të lëndës për të nxitur aftësinë e të kuptuarit, analizës dhe zbatimit të koncepteve në praktikë, si dhe 30% është testimi gjatë vitit.

Ky rekomandim është plotësuar.

- d) Për rekomandimin të këtë një specializim më të qartë të stafit akademik në fusha të caktuara në mënyrë që të rritet niveli i mësimdhënies, institucioni ka rekrutuar staf të ri. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative gjatë vitit 2015-2016 ka angazhuar gjithësej 23-24 pedagogë të brendshëm dhe me kontratë, kurse gjatë vitit akademik 2016-2017, vërehet i njëjti numër pedagogësh, por ka disa ndryshime në përbërjen e stafit, e vërtetuar kjo nga dokumentat e vendimarrjes së Bordit Administrativ të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative kërkuara nga GVJ. Ndryshimi i stafit është argumentuar me mos rinovimin e kontratave të përfundura dhe marrjes si staf me kontratë të brendshme i 1 pedagogu.

Ky rekomandim është plotësuar.

- e) Për rekomandimin e koordinimit më të mirë të kohës së qëndrimit të profesorëve në mënyrë që mos të krijohet mbingarkesë mësimore, institucioni ka rritur numrin e stafit efektiv dhe me kontratë të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative në 17 pedagogë efektivë dhe 10 pedagogë me kontratë, nga të cilët Departamenti i Ekonomiksit ka 7 pedagogë efektiv dhe 2 me kontratë.

Ky rekomandim është plotësuar.

- f) Për rekomandimin të organizohet më mirë orari dhe ngarkesa mësimore nga profesorë të huaj, Institucioni e mbështet mësimdhënien për këtë program studimi "Bachelor në Ekonomiks" me 17 Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 10 Personel Akademik me Kontratë (PAK).

Ky rekomandim është plotësuar.

- g) Për rekomandimin të rritet numri i stafit të kualifikuar të cilët janë të punësuar, institucioni ka rekrutuar staf PAE dhe PAK ku nga 17 pedagogë PAE, 7 prej tyre ose 41 % janë me tituj dhe grada shkencore dhe nga 10 PAK, 20 % janë me grada dhe tituj shkencorë.

Ky rekomandim është plotësuar.

- h) Për rekomandimin të përgatiten programe të plota të kërkimit shkencor dhe të rritet pjesëmarrja në projekte kërkimore që shërbejnë për ekonominë Shqiptare, IAL e inkurajon stafin akademik për të zhvilluar punë kërkimore shkencore dhe ofron mbështetjen financiare për realizimin



e saj. Universiteti ofron gjithashtu mbështetjen financiare për realizimin e projekteve shkencore, pjesëmarrjen e stafit në konferenca dhe veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit. Tematika e botimeve dhe projekteve kërkimore është në ndihmë të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. IAL zotëron një bazë të dhënash mbi veprimtarinë kërkimore shkencore.

Ky rekomandim është plotësuar.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Misioni i Universitetit “Epoka” është rritja e individëve të mirëpërgatitur, produktivë dhe kompetent me një shpirt të orientuar nga kërkimi, të cilët zotërojnë etikën profesionale dhe ndjeshmërinë për vendin dhe realitetin në ditët e sotme, në mënyrë që të shërbejnë për vlerat themelore të njeriut, të kontribuojnë në cilësinë e jetës së njerëzve, bazuar në nevojat universale dhe rajonale. Vizioni i Universitetit “Epoka” është të jetë lider në vendin tonë në fushën e arsimit, kërkimit dhe zhvillimit, duke qënë në shërbim të plotë të shoqërisë. Bazuar në ligjin nr. 80/2015, “ Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe kuadrit të Riakreditimit Institucional, Universiteti “Epoka” është duke punuar për Planin Strategjik 2018 - 2022 të Universitetit “Epoka”, si dhe Departamenti i Ekonomiksit ka hartuar Planin Strategjik 2017-2022. Hartimi i Planit Strategjik 2017- 2022 është në mbështetje të vizionit Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative si dhe të Departamentit të Ekonomiksit, *që synon përgatitjen e stafëve të kualifikuara në përshtatje me ndryshimet e vazhdueshme në fushën ekonomike dhe e aftë për të punuar në administratë, në nivel qendror dhe lokal, në organizata jo qeveritare si dhe në kompani private.* Sipas këtij plani, Departamenti i Ekonomiksit ka përcaktuar objektiva strategjike në 5 drejtime kryesore:

Objektiva strategjike që lidhen me sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të të mësuarit (tërheqja e stafëve akademike të kualifikuara; rritje e pjesëmarrjes të stafëve akademike në trajnime në fushat e tyre të ekspertizës; zgjerimi global i departamentit duke kryer aktivitete të ndryshme në mësimdhënie apo kërkim shkencor; sigurimi i përdorimit të teknologjive moderne të mësimdhënies; rritja e produktivitetit të stafit dhe fakultetit duke përdorur më shumë teknologjitë e informacionit).



Ojektiva strategjike që lidhen me rritjen e numrit të studentëve cilësorë të rregjistruar; rritja e raportit të diplomimit; rritja e studentëve në eksperiencë ndërkombëtare; rritja e aftësive të studentëve për t'i bërë sa më të kërkueshëm nga tregu i punës.

Objektiva strategjike që kanë të bëjnë me rregjistrimin, arsimimin dhe diplomimin e studentëve cilësorë; të ofrojë mundësi kërkimore për problemet dhe nevojat kombëtare, të njohurive ndërdisiplinare dhe aftësive globale ekonomike; rritja e konkurrueshmërisë për studentët e diplomuar vendas; të arrijnë të sigurojnë më shumë bursa të financuara nga jashtë për studentët.

Objektiva strategjike lidhur me rregjistrimin, arsimimin dhe diplomimin e studentëve të ndryshëm të Doktoraturës; angazhimi në kërkime ndërdisiplinare ndërmjet departamenteve të ndryshme të Universitetit “ Epoka”; angazhimi në kërkime të ndryshme shumëkombëshe; të inkurajojë stafin e fakultetit dhe studentët të jenë aktiv në aspektin profesional. Këto mendon t'i arrijë duke rritur me 10 % fondin e financimit për aktivitete aktuale dhe të reja, rritja me 25% e publikimeve dhe prezantimeve me studentët e doktoraturës.

Objektivi i pestë strategjik lidhet me sigurimin e mjediseve cilësore kërkimore; inkurajimin dhe mbështetjen e stafit akademik që të rrisë cilësinë dhe produktivitetin e kërkimeve; të tërheqë dhe të mbaj staf të kualifikuar dhe të forcojë reputacionin e Departamentit. Përfshirja e tre shtyllave kryesore, mësim-kërkim- kontribut në shoqëri, duke rritur aktivitetet sociale të akademikëve, bizneseve dhe organizatave jo qeveritare si dhe duke orientuar projektet kërkimore në përputhje me nevojat e tregjeve Shqiptare dhe më tej.

Objektivat e Programit “Bachelor” në Ekonomiks janë:

- Përvetësimi i koncepteve bazë në lidhje me fushën e ekonomiksit dhe përdorimi i tyre me efikasitet
- Integrimi i teorikës, praktikës dhe politikave të ndryshme në mënyrë që studentët të kuptojnë mënyrën e funksionimit të politikave ekonomike
- Krijimi i parakushteve për zhvillim të vazhdueshëm si rezultat i ofrimit të programeve shumë cilësore dhe konkurente në tregun e dijes.
- Ndërgjegjësimi i studentëve për të kontribuar për komunitetin
- Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi me të mësuarit gjatë gjithë jetës në mënyrë që t'i përshtaten tregut të punës.
- Përcjellja e trendeve në funshën e shkencës dhe praktikës së ekonomisë



- Përgatitja e kuadrove në fushat e ndryshme të ekonomisë në Shqipëri, rajon dhe më gjerë.
- Përgatitja e liderve me formim të thelluar shkencor në fushën e drejtimit, ekonomisë, zhvillimit të burimeve njerësore, sjelljes organizative dhe kërkimit shkencor
- Përgatitja e specialistëve në fushën e ekonomisë në vend.

Universiteti “Epoka” ofron studime në fushën e ekonomiksit në të tre ciklet e studimit (bachelor, master dhe doktoraturë), të cilat drejtohen nga departamenti i ekonomiksit. Misioni i Departamentit të Ekonomiksit është përgatitja e individëve të kualifikuar, që mund të shërbejnë në sektorin privat, publik dhe në organizata jo fitimprurëse, duke siguruar një arsimim të gjerë profesional. Ai e realizon këtë duke ndërthurur mësimdhënien me kërkimin shkencor dhe praktikën profesionale.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Misioni i programit të studimit përputhet me qëllimet dhe misionin e Institucionit. Programi materializon objektivat strategjikë të IAL në fushën e Edukimit, kërkimit dhe formimit profesional.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ai i përgjigjet kërkesës për përgatitjen e ekonomistëve, një specializim që kërkohet kryesisht në Institucionet publike (qëndrore dhe vendore), por dhe në sektorin privat.</p> <p>Programi mban parasysh zhvillimin ekonomik të vendit, nevojat për përgatitjen e specialistëve të aftë për të punuar për zhvillimin e politikave ekonomike.</p> <p>Programi i studimit pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Në programin që vlerësohet kjo realizohet përmes përfshirjes në programin e studimit të moduleve me zgjedhje që trajtojnë problematikat që lidhen me ekonominë Shqiptare, Zhvillimin rajonal dhe Qeverisja, Analiza dhe Menaxhimi I krizave, etj.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Sipas RVB, dokumentacionit të programit dhe takimit me titullarët, u konstatua që PS është përshtatur dhe zhvilluar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të IAL.</p> <p>Viti i parë i programit përbëhet nga lëndë të formimit bazë dhe lëndë hyrëse për profilin e ekonomisë. Viti i dytë dhe i tretë përfshijnë lëndë të parimeve shkencore të përgjithshme. Program i studimeve “Bachelor” në Ekonomiks synon formimin në një gamë të gjerë profesionale si specialist në administratën publike për çështjet ekonomike, kontabilist apo Menaxher, në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Me zhvillimin e vazhdueshëm të tregut të punës, konkurrenca do të behet edhe më intensive. Ky PS siguron zhvillimin e aftësive të mendimit kritik, të komunikojnë qartë, të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që ata marrin, të njohin rolin dhe rëndësinë që ka menaxhimi efektiv i ekonomisë për shoqërinë, për të qenë të suksesshëm në punësim në tregun vendas apo të huaj. Sipas të dhënave për punësimin e studentëve për periudhën 2012-2016, rezultojnë 39 të diplomuar nga të cilët 37 janë të punësuar.</p> <p>Universiteti Epoka ka vlerësuar nevojat e tregut të punës nëpërmjet një studimi deri në vitin 2011, vit që mori akreditimin e programit të studimit Bachelor në ekonomiks 4 vjecar. Gjithashtu disa student nën udhëheqjen e pedagogut kanë kryer një studim lidhur me perceptimin dhe motivet që shtyjnë gjimnazistët të zgjedhin të studiojnë Ekonomiks. Kërkesat në rritje të punëdhënësve, vlerësohen nga Institucioni duke u bazuar në numrin në rritje të studentëve të rregjistruar për këtë program nga 8 studentë të rregjistruar në 2012 në 31 studentë në 2016 me një rritje të konsiderueshme prej 4 herësh. Për vitin akademik 2017-2018 priten të regjistrohen 40 studentë.</p> <p>Gjithashtu, në Planin Statëgjik 2017 – 2022 të Departamentit, parashikohet rritja e studentëve të ardhur nga jashtë. Megjithatë, mendoj se mbetet ende sfidë për Institucionin rritja e numrit të studentëve në vitet në vijim.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore	

kombëtare dhe interesave kombëtare.

Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;

Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Programet e studimit të ofruara nga Universiteti “Epoka” dhe politikat e ndjekura janë hartuar në përputhje me politikat kombëtare mbi arsimin e lartë të MASH.

Programet janë në harmonizim të plotë me vlerat kulturore e kombëtare.

Konkluzione të GVJ:

Programi i studimit “Bachelor” në Ekonomiks përputhet me strategjinë për zhvillim të Institucionit dhe është hartuar në përputhje me strategjinë afatmesme për zhvillimin e tij. Në hartimin dhe zbatimin e këtij programi janë mbajtur parasysh plotësimi i kushteve dhe parakushteve të rrjedhura nga Ligji i Arsimit të Lartë dhe Udhëzimet përkatëse të MAS. Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimet përkatëse të MAS.

Mendoj se mungon promovimi i mjaftueshëm i Universitetit “Epoka” ndaj publikut të gjerë dhe grupeve të synuara dhe se mbetet ende sfidë për Institucionin rritja e numrit të studentëve në vitet në vijim.

Shënim: Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 312, datë 27.07.2012, në lidhje me ri-organizimin e programit të studimit në fjalë, nuk përmban ndonjë dispozitë që kërkon ri-akreditimin e programit të studimit

Standartet e mësipërme përmbushen plotësisht.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)**Pjesa përshkrimore**

Universiteti “Epoka” përbëhet nga 3 Fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Fakulteti i Arkitekturës dhe i Inxhinjerisë dhe me Urdhër Nr. 116, datë 13.03.2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për “Hapjen e Njesisë kryesore dhe Riorganizimin Institucional të Universitetit “Epoka”, është hapur Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

Në Raportin e GVB-së, Universiteti Epoka paraqitet me dy fakultete pasi raporti është dorëzuar në Shkurt, kurse Urdhri i MAS, Nr 116, mban datën 13.03. 2017

Universiteti “Epoka” përbëhet nga 3 Qendra Kërkimore: Qendra e Kërkimit dhe Projektimit në Arkitekturë, Qendra e Studimeve Europiane dhe Qendra për Arsim të Vazhdueshëm.

Fakultetet janë njësi kryesore që bashkërendojnë mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative përbëhet nga katër departamente dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinjerisë me tre departamente.

Urdhëri i MAS, nr. 116, datë 13.03.2017, për “ Hapjen e njësisë kryesore dhe riorganizimin Institucional të universitetit “Epoka”, hap njësinë kryesore “Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale” me tre Departamente (Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Departamenti i Drejtësisë; Qendra për Studime Europiane) dhe organizon dy Fakultetet e tjera me 3 Departamente.

(dokumenti i siguruar nga vizita e GVJ në IAL).

Përshtatja e Statutit të Universitetit “Epoka” bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2105 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të Republikës së Shqipërisë.”

GVJ iu vendos në dispozicion Urdhëri MAS, nr. 146, Datë 31.03.2017 për “Miratimin e Statutit të Universitetit “Epoka”, propozuar me vendimin e Senatit Akademik Nr. 2, datë 14.12.2017. Përcaktimet e këtij statuti lidhur me organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, duhet të pasqyrohen brënda vitit akademik 2017-2018. IAL është duke punuar intensivisht për hartimin e të gjitha akteve dhe dokumentave ligjor që lidhen me këtë statut.


Më poshtë po paraqesim strukturën që ka funksionuar deri në vitin akademik 2016-2017 (*GVB ka dorëzuar raportin në Shkur, ndërsa Miratimi i Statutit është bërë në muajin Mars*)

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative drejtohet nga organet kolegjiale: Këshilli i Fakultetit dhe Këshilli i Administrimit të Fakultetit dhe nga autoritete drejtuese që janë dekani, zëvendës dekani, kancelari dhe përgjegjësit e departamenteve.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative si njësi kryesore është paraqitur nga GVB nga katër departamente, ku sicili prej tyre ka mision dhe objektiva të mirëpërcaktuara.

- Departamenti i Ekonomiksit
- Departamenti i Financë- Bankës
- Departamenti i Administrim Bisnesit
- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Urdhëri nr.116, datë 13.03.2017, e organizon këtë fakultet në 3 departamente, duke kaluar Departamentin e Shkencave Politike dhe Mardhenieve ndërkombëtare në Fakultetin e Drejtësisë



Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimarrës, i cili përcakton veprimtarinë e Fakultetit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor bazuar në propozimet e marra nga departamentet. Këshilli përbëhet nga 7 anëtarë dhe drejtohet nga Kryetari. Anëtarët e Këshillit janë Dekani, që është dhe Kryetar i Këshillit, shefat e departamenteve, drejtori i qendrës kërkimore, një anëtar nga stafi akademik dhe sekretari i këshillit që raporton mbi veprimtarinë e këshillit. Këshilli vepron për një periudhë katër vjecare dhe kompetencat e tij përcaktohen me rregulloren e IAL.

Këshilli Administrativ i Fakultetit është organ kolegjal që përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit. Ky Këshill ka mandat katër vjecar dhe drejtohet nga Dekani. Anëtarë të këshillit janë katër antarë të stafit akademik që zgjidhen për një mandat katër vjecar nga Këshilli i Fakultetit, duke marrë në konsideratë titujt e tyre akademikë. *Sipas të dhënave të shqyrtuara nga RVB si dhe vizitës në IAL, u konstatua që anëtarë të këtyre dy organeve kolegjiale janë të njëjtit persona.*

Dekani është udhëheqës kryesor i fakultetit dhe emërohet me propozim të Rektorit dhe miratim të Këshillit të Lartë për një periudhë katër vjecare me të drejtë rizgjedhje. Dekani i fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative mban Titullin “ Prof. Asc.Dr”

Përgjegjesi i Departamentit, është autoriteti më i lartë i njësisë bazë mësimore kërkimore. Përgjegjësi i departamentit zgjidhet nga Dekani mes anëtarëve të brendshëm të stafit akademik të departamentit, miratohet nga rektori dhe emërohet nga Këshilli i Lartë për një periudhë katër vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Treguesit e matshëm.

Departamenti e Ekonomiksit nuk është i ndarë në seksione dhe ka në përbërjen e tij 13 anëtarë, prej të cilëve 7 janë Personel Akademik Efektiv (PAE), 2 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK) dhe 4 Personel Administrativ.

Stafi akademik i departamentit të Ekonomiksit ka 1 (një) anëtar që mban titullin Prof.Dr, 1 (një) anëtar që mban titullin Prof Asc. Dr, 2(dy) me gradën Dr dhe 5 (pesë) antarë me kualifikimin master MSC.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Urdhri nr. 166, datë 13.03.2017 për “ Hapjen e Njësisë kryesore dhe Riorganizimin Institucional të Universitetit “Epoka”.
- Organigrama e Universit “Epoka”
- Urdhërin për miratimin e statutit të Universitetit “Epoka”. Urdhëri i MAS, Nr. 146, datë 31.03.2017 “ Për Miratimin e Statutit të Universitetit Epoka”, miraton statutin e propozuar me vendim të senatit Akademik nr.2, datë 14.12.



3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit **Pjesa përshkrimore**

Personeli akademik dhe drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit kryejnë veprimat të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e IAL, këshillim për studentët, detyra administrative, në përputhje me detyrat e përcaktuara në statutin e Universitetit “Epoka” dhe të rregulluara me Kontratën Individuale të Punës, e cila bazohet në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë. Personeli drejtues, akademik dhe ai ndihmës i Universitetit “Epoka” përbëhet nga vendas dhe të huaj, i cili sjell një diversitet kulturor të stafit. GVJ gjatë vizitës evidentoi se një pjesë e mirë e operacioneve dhe aktiviteteve zhvilloheshin në më shumë se një gjuhë .

Mësimdhënia në këtë PS mbulohet nga Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) dhe Personel Administrativ. Mësimdhënia mbulohet kryesisht nga pedagogë të Departamentit të Ekonomiksit, ndërsa një pjesë e moduleve (kryesisht ato me zgjedhje) mbulohen nga pedagogë të Departamentit Financë-Bankë dhe Departamentit të Administrim Biznesit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

- Për këtë program studimi janë angazhur 27 pedagogë, nga të cilët 17 janë Personel Akademik Efektiv (PAE), 10 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK) dhe 4 Personel Administrativ (PA). Nga 17 pedagogë dhe punonjës kërkimor, 10 ose 58,8 % janë me tituj dhe grada.

Ndarja e tyre sipas titujve dhe gradave jepen në Tabelat Aneksi 3, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB

Indikatorët që lidhen me Personelin Akademik dhe atë Administrativ janë:

Raporti PAE/PAK në këtë program është $17/10 = 1.7$

Raporti Personel Akademik/Personel Administrativ $27/4 = 6.75$

Raporti Personel Akademik./Student $27/79^2 = 0.34$ (një personel akademik për cdo tre studentë)

Raporti Personel Administrativ/Student $4/79 = 0.05$

Raportet gjinore janë përgjithësisht të balancuara në radhët e personelit akademik të departamentit të Ekonomiksit. Raporti M/F në Personelin

² Ky numër studentësh nuk përfshin vitin akademik 2016-2017

Akademik Efektiv është 4/3, ndërsa për Peronelin Akademik me Kontratë 0/2. Në total raporti M/F është 4/5.

PAE përbëhet nga disa grup moshë. 4 janë në grup moshën 25-30 vjec, 5 janë në grupmoshën 36-45 vjec dhe 1 në grupmoshën 46-55 vjec. Përbërja e stafit sipas moshës mundëson harmonizimin më të mirë të stafit me përvojë me stafin e ri dhe është një faktor i rëndësishëm për fuqizimin e njësisë.

Universiteti : Epoka” ka kritere të shpallura për vlerësimin dhe rekrutimin e kandidatëve. Në kontratën individuale të punës janë të sanksionuara qartë të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësve dhe punëdhënësit, paga, sigurimet shoqërore dhe përfitimet e tjera, largimi nga puna, zgjidhja e kontratës, etj.

Rekrutimi i stafit bëhet nga zyra e Burimeve Njerëzore. Kriteret e rekrutimit përgatiteten në përputhje me vendet e lira të punës. Për stafin akademik preferohen persona me tituj dhe grada shkencore, ata që janë diplomuar në universitete të huaja dhe ata që kanë përvojë në mësimdhënie.

Marrëdhëniet e punës rregullohen me kontratën individuale të punës, e cila nënshkruhet nga Administratori i Univesrsitetit, në cilësinë e punëdhënësit. Kontratat e punës janë 1 vjecare. Universiteti ka dhe sistemin online, ku mund të aplikohet për pozicione të lira pune.

Dosjet e stafit akademik ndodhen pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore. Gjatë vizitës në institucion u kostatua që për të gjithë personelin akademik dhe administrativ ka dosje të plota. Dosjet përmbanin gjithë dokumentacionin që kërkohet sipas Kodit të Punës.


Ndarja e ngarkesës mësimore bëhej në bazë të nenit 2/a, të Udhëzimit 20 mbi Ngarkesën Mësimore dhe zbatohet në përputhje me marrëveshjet e punës. Ngarkesa mësimore merrte në konsideratë detyrat akademike dhe administrative të personelit. Ngarkesa javore është si mëposhtë:

Rektori 3 orë, Zv rektori 6 orë, Dekani 6 orë, Shefi i departamentit 10 orë, Prof. Dr 12 orë, Lektor 18 orë, Instrukorë 20 orë.

Departamenti i Ekonomiksit ka vetëm një staf ndihmës, që mbështet personelin akademik.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	



<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Rekrutimi i stafit bëhet në përputhje me IAL dhe bazohet në procedura ligjore dhe transparente. Në rekrutimin e stafit përfshihen disa struktura të Bordit Administrativ, komisioni me akademikë dhe vendimi përfundimtar jepet nga Këshilli I Lartë i universitetit. Zyra e Burimeve Njerëzore kishte lista dhe dosje të plotë të personelit me kohe të plotë dhe më kontratë. Në mënyrë rastësore u përzgjedhën 2 emra dhe u verifikuan që dosjet përmbanin të gjithë dokumentacionin.</p> <p>Personeli Akademik me Kohë të plotë përbën 17/27 të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Nga takimi me Njësinë për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme u informuam që vlerësimi i personelit akademik kryhej në disa mënyra: vlerësimi nga studentët; vlerësimi nga përgjegjësi i Departamentit dhe vlerësimi nga drejtuesit e IAL. Për secilën nga format kishte procedura të përcaktuara qartë. Gjithashtu ka një system të vlerësimit me pikë të stafit për cdo artikull, botim, në revista prestigjioze, ku cdo pikë kishte kundravlerë monetare, e cila mbështeste stafin në pune të ardhshme kërkimore shkencore. IAL ka dhe versionin online për vlerësimin e personelit akademik. Vlerësimet e stafit bëhen publikë.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore kishte një dosje të vecantë me njoftimet për punë apo kërkesat për fuqi punëtore, të cilat i dërgohen gjithashtu edhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Universiteti “Epoka” kishte dhe databazën e tij, në të cilin ruheshin të gjitha aplikimet online për një pozicion pune të caktuar.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka të dhëna për personelin akademik të përfshirë në program të sistemuara në dosjen personale të cdo pedagogu, si dhe për personin përgjegjës për PS.</p> <p>Në fund të cdo viti dosjet përditësohen me angazhimin kërkimor shkencor për të gjithë personelin akademik.</p> <p>Universiteti “Epoka” dispononte një listë të plotë të stafit akademik, të personelit ndihmës mësimor shkencor dhe personelit administrativ të gjithë Institucionit. Kjo listë është dorëzuar dhe në MAS, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura.</p> <p>IAL ka përcaktuar kriteret dhe procedura të qarta për rekrutimin e PA. IAL i publikon ato rregullisht në website, kur lind nevoja për rekrutime të reja. Ka një modul online të instaluar në faqen e Universitetit.</p>

<p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor”, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</p> <p>Në Programin “Bachelor në Ekonomiks”, në Universitetin “Epoka”, titullari i lëndës ka të paktën gradën shkencore Master Shkencor, në bazë të nenit 59, pika 6 e Ligjit Nr. 80/2015,“ Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kjo vihet re dhe në syllabus-et e Lendeve.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Kurrikula e PS nuk përmban orë laborator, megjithatë Universiteti “Epoka” ka Personel të mjaftueshëm që mundëson mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore.</p> <p>Shpërndarja e burimeve njerëzore midis njësive bazë të Fakultetit është bërë në përputhje me nevojat e departamenteve si dhe duke mbajtur në konsideratë kualifikimin individual të stafit. Raporti Personel akademik/ Personel Administrativ është optimal dhe mundëson përmbushjen e misionit të PS.</p> <p>Kurrikula e programit “Bachelor” në Ekonomiks nuk parashikon praktikë profesionale, por studentët në fund të cdo viti akademik me mbështetjen e Zyrës së Karrierës aplikojnë në Institucione të ndryshme publike si dhe kompani private, brenda dhe jashtë vendit për kryerjen e praktikave kryesisht gjatë sezonit të verës.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Universiteti “Epoka”organizon në mënyrë të vazhdueshme trajnime për stafin në fusha të ndryshme. Përmendim trajnimet e kryera në fusha si Classroom Technologies, Moodle, Turnitin, Sistemin EIS, trajnime për përdorimin E-VIEËS nga studentët e doktoraturës, trajnime mbi mbrojtjen dhe evakuimit nga zjarri,etj. Megjithatë, GVJ gjatë vizitës në IAL, evidentoi se një pjesë e mirë e operacioneve dhe aktiviteteve zhvilloheshin në më shumë se një gjuhë dhe kjo mendoj se mund të sjellë konfuzion, lodhje dhe ineficencë të stafit të IAL-së.</p> <p>IAL disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara, ku përfshihen të dhëna për studentët, aktivitetet shkencore dhe ato sociale.</p>

Konkluzione të GVJ:

Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve. Në kontratat e punës dhe të shërbimit janë specifikuar përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të ofruara. Universiteti “Epoka ka një zyrë të burimeve njëreze, e cila merret me politikën e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit dhe ruan të gjitha të dhënat për personelin. Procedurat e ndjekura për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit janë ligjore dhe transparente.

Personeli akademik është angazhuar në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit. Nevojat e IAL për personel akademik me grada dhe tituj për këtë program studimi mbulohen nga PAE dhe PAK.

IAL zbaton aktet Ligjore dhe nënligjore për ngarkesën mësimore.

IAL ka angazhuar personel mjaftueshëm për të përmbushur misionin e tij. IAL organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm të personelit akademik dhe të personelit kërkimor-shkencor. IAL disponon një bazë të dhënash për programet e ofruara.

Personeli akademik, administrativ dhe ai ndihmës i Universitetit “Epoka” përbëhet nga shtetas vendas dhe të huaj, i cili mendoj se paraqet një sfidë për Menaxhimin e këtij Institucioni, sfidë që rrjedh nga puna me një staf me diversitet kulturor. Gjithashtu, pavarësisht trainimeve të shumta nga ana e IAL-së, GVJ gjatë vizitës në IAL, evidentoi se një pjesë e mirë e operacioneve dhe aktiviteteve zhvilloheshin në më shumë se një gjuhë dhe kjo mendoj se mund të sjellë konfuzion, lodhje dhe ineficencë të stafit të IAL-së.

Pavarësisht sa më sipër, mendoj se Standardet e mësipërme përmbushen plotësisht

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**Pjesa përshkrimore**

Universiteti “ Epoka” e zhvillon aktivitetin e tij në Kampusin qendror të Rinasit, i cili përbëhet nga dy godina të reja me sipërfaqe totale 14.352 m².

Kampusi ndodhet në afërsi të aeroportit të Rinasit dhe në distancë 12 km nga Tirana. Sipërfaqja totale e kampusit është 67.000 m² dhe në të cilën përveç godinave që zhvillohet mësimi, ka dhe një godinë për akomodimin e studentëve dhe dy ambjente parkimi. Viti akademik 2016-2017 po zhvillohet në ambjentet e dy godinave tashmë të përfunduara me një sipërfaqe 14352m².

Projektet e godinave janë bashkëkohore dhe plotësojnë të gjitha standardet për të zhvilluar vprimtarinë kërkimore shkencore. Godinat kanë të instaluar një sistem qendror ngrohje- ftohje. Të gjitha auditoret janë të pajisura me videoprojektorë dhe në disa salla ka tabela inteligjente, të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor.

Biblioteka e Universitetit “Epoka” funksionon si pjesë përbërëse e Institucionit. Shërbimi bibliotekar kryhet prej punonjësve të caktuar posacërisht nga Institucioni dhe ofrohet për stafin akademik dhe studentët. Biblioteka ka një sipërfaqe prej 400 m². Biblioteka ka një sallë leximi me një kapacitet prej 80 vendesh. Salla e leximit është e projektuar me qëllim që studentët të kenë mundësi për të studiuar dhe për të bërë kërkime. Biblioteka ka një fond librash për PS. Librat janë në gjuhë të ndryshme: shqip, anglisht, turqisht dhe gjuhë të tjera. Në mjediset e Bibliotekës ka dhe shërbim interneti.


Biblioteka përvec fondit të librave mundëson akses në 6 librari online. Në Tetor 2014 Universiteti “Epoka” u bë anëtare me të drejta të plota në JSTOR, e cila konsiderohet si një nga libraritë më të përshtatshme për këtë PS. Aksesit në një gamë të gjerë të burimeve elektronike me tekst të plotë është i disponueshëm pa pagesë për stafin, studentët dhe përdoruesit e Bibliotekës. IAL ofron disa shërbime për studentët, të cilat ofrojnë shërbim të shpejtë dhe rrisin transparencën e Institucionit.

Shërbimet e ofruara janë:

Sistemi i Informacionit për cështjet e studentëve (SAIS)- sistemi jep mundësi të aksesohen informacione personale, njoftime të ndryshme, lëndë të cilat duhet të rregjistrohen, lëndë të cilat janë rregjistruar në semestrin përkatës, lëndët që departamenti ofron, etj. Në këtë sistem studentët mund të marrin listën e notave, mund të llogaritin mesataren e tyre, orarin javor, pjesëmarrjen në leksione, datat e provimeve, profesorët e lëndëve dhe njoftime të ndryshme.

Sistemi i informacionit të Stafit (SIS) – sistemi përmban të gjithë informacionet e nevojshme të stafit akademik dhe administrativ. Personeli akademik ka akses tek lëndët që ai është lektor, në orarin e mësimeve, mund të bëjë plotësimin e pjesëmarrjes së studentëve në mësim, të plotësojë syllabusin e lëndëve dhe vlerësimin e studentëve, etj. Në këtë sistem ka një modul të caktuar për përzgjedhjen dhe pranimin e studentëve; një modul ku ndiqet ana financiare e cdo studenti. Zyra e Burimeve Njerëzore rregjistron të gjitha të dhënat rreth personelit të Universitetit në një modul të caktuar, etj.

Moodle – është një shërbim online, i cili iu ofron studentëve mundësinë të aksesojnë leksionet e tyre në mënyrë interaktive kudo që janë dhe kanë mundësi interneti. Profesorët e lëndëve i azhurnojnë në këtë server të gjitha leksionet dhe materialet që kanë lidhje me lëndën dhe studentët pasi pajisen



me emër përdoruesi dhe fjalë kalimi nga profesori, kanë mundësi t'i aksesojnë ato.

Sistemi i Informacionit të Edukimit (EIS) – ofron për studentët informacionin e nevojshëm në lidhje me Universitetin, programet që Universiteti ofron, programet e shërbimit të studentëve, njohjen e diplomave, rregulloren e Universitetit, etj.

Google classroom – është një shërbim i mundësuar nga google si pjesë e paketës Google Apps for Education. Ky shërbim u mundëson studentëve të kenë akses në leksionet e tyre në mënyrë interaktive. Profesorët e lëndëve i azhurnojnë sistematikisht të gjitha leksionet dhe materialet që kanë lidhje me lëndën dhe gjithashtu kanë mundësi të integrojnë materialet mësimore me shërbimet që ofron Google. Studentët dhe profesorët e aksesojnë këtë shërbim me anë të email-it zyrtar që janë pajisur nga Universiteti “Epoka”.

Ëebmail – Universitetit “Epoka” pajis të gjithë studentët e tij me adresë email -i, adresë të cilën studenti e ka për përdorim të përhershëm. Të gjitha informacionet ose njoftimet e ndryshme i komunikohen studentit nëpërmjet kësaj adrese email-i.


Email group – është një shërbim që ofrohet për klubet e studentëve të Universitetit “ Epoka”.

Sistemi i Automatizuar i Bibliotekës (LAS)- mundëson akses online tek burimet e materialeve që ofron universiteti. Në këtë sistem ndiqet në mënyrë interaktive lëvizja e librave të Bibliotekës, të gjithë studentët që duan të huazojnë librat e Universitetit jashtë Bibliotekës rregistrohen në sistem. Nëse ndonjë studenti i kalon afati i dorëzimit të librit të huazuar, sistemi i dërgon email në mënyrë automatike, ku i kujton që duhet të kthejë librin e marrë.

Dspace – është sistemi i arkivës dixhitale, i cili u mundëson studentëve të kenë akses në materialet akademike nga konferenca të ndryshme që organizon Universiteti.

Në godinën A, pëvec klasave të mësimi, ka dhe shumë ambiente shlodhëse për studentët si mensë, kafeteri, bibliotekë, sallë interneti, mjedise për Këshillin Studentor dhe klubet studentore etj.

RVB përmban të dhëna të hollësishme mbi infrastrukturën në funksion të mësimi, logjistikën dhe shërbimeve të tjera në funksion të komunitetit. Të dhënat e raportuara përputhen me të dhënat e verifikuara gjatë vizitës në IAL.



Treguesit mbi mjediset për programin e studimit dhe mjediset për stafin janë deklaruar me korrektësi në tabelat e paraqitura në RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Në bibliotekën e IAL ka tekste mësimore cilësore në funksion të PS. IAL ka akses në disa biblioteka online, të cilat sigurojnë literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore për të realizuar kërkimin shkencor të studentëve.</p> <p>Literatura që ndohet në bibliotekë i ndihmon studentët për të realizuar me sukses PS. Aty ka gjithashtu literaturë të mjaftueshme për të realizuar kërkimin shkencor dhe përgatitur temën e diplomës.</p> <p>Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projekteve kërkimore-shkencore.</p> <p>Abonimi në JSTOR apo burime të tjera elektronike si Cambridge Journals Online, Sciencedirect, Emerald, IOP science, OECD – iLibrary, etj, plotësojnë nevoja e PS për botime periodike dhe literaturë bashkëkohore.</p> <p>Përdoruesit (student dhe pedagogë) mund të bëjnë kërkesë për materiale të rinj duke paraqitur formularin e kërkesës, e cila duhet të jetë miratuar nga përgjegjësi i njësisë respektive dhe Sekretari i Përgjithshëm. <i>Gjatë vizitës në IAL nuk u njohëm për egzistencën e një plani të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, por IAL përmes buxhetit Institucional siguron pasurimin e fondit të bibliotekës.</i></p> <p>Oraret e punës së bibliotekës janë të shpallura në mjediset e Institucionit. Ato janë të shfaqura dhe në hyrje të bibliotekës. Orari nuk është i mjaftueshëm për studentët që duan ta frekuentojnë edhe në orët e vona të pasdites apo gjatë ditës së shtunë.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit</p>	<p>Sipas të dhënave të detajuara të RVB-së dhe vizitës në IAL konstatuam që ky Institucion ka hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e PS. Viti akademik 2016-2017 po zhvillohet në ambjentet e dy godinave tashmë të përfunduara</p>

<p>tëstudimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>me një sipërfaqe 14352m².</p> <p>Klasat dhe auditorët janë të pajisura me të gjithë infrastukturën e nevojshme për një proces mësimor efektiv, sistem kondicionimi, dërrasë interaktive (smart board), Internet, etj.</p> <p>Program “Bachelor” në Ekonomiks nuk ka natyrë teknike, për të cilat nëvojiten laboratorë eksperimenti.</p> <p>Ky kriter nuk vlen për këtë program studimi.</p> <p>Për të përmbushur nevojat e programeve është ngritur laboratori i informatikës. Për të bërë të mundur një mësimdhënie sa më efektive dhe për t’u ardhur në ndihmë studentëve, Universiteti ka instaluar programe bashkëkohore kompjuterike. Në 41 kompjutera të laboratorit, në 13 klasa dhe në 10 kompjutera në bibliotekë, janë instaluar programet: EVIEWS, Ubuntu Desktop Apps, etj.</p> <p>Universitetit “Epoka” zotëron hapësira të mjaftueshme si laboratorë, klasa, mjedise me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që plotësojnë kërkesat e aktiviteteve të ndryshme akademike.</p>
<p><u>Konkluzione të GVJ:</u></p> <p>Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet konkludoj se Universitetit “Epoka” ka siguruar infrastukturën e nevojshme për realizimin e programit të studimit “Bachelor në Ekonomiks”, ka vënë në dispozicion të studentëve të tij bibliotekën, që përmban fonde librash dhe akses në biblioteka online.</p> <p>IAL ka investuar në pajisjen e mjediseve mësimore me infrastrukturë bashkëkohore</p> <p><i>Sugjeroj të shikohet mundësia e aksesit në bibliotekë deri në orën 21:00 gjatë ditëve të javës</i></p> <p><i>Standardet e mësipërme përmbushen plotësisht</i></p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Universiteti “Epoka” është pjesë përbërëse e shoqërisë “Turgut Ozal Education” sh.a. Menaxhimi financiar i universitetit bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e “Turgut Ozal Education” sh.a dhe Zyra e Financës së



Universitetit “Epoka”. Institucioni financohet vetëm nga burime private dhe auditohet cdo vit në mënyrë të rregullt nga një kompani auditimi e pavarur. Burimet e financimit janë tarifatat e studentëve që gjatë vitit 2015 – 2016 zënë 94,2 %, të ardhurat nga aktiviteti tregtar që gjatë vitit 2015-2016 kanë zënë 5,8% dhe deri në vitet 2013-2014 grantet për kërkim dhe kontratat kanë zënë 0.3%. Për vitet akademike 2014-2015, 2015- 2016 institucioni nuk ka siguruar të ardhura nga grantet.

Për të gjitha vitet e raportuara pjesa më e madhe e të ardhurave nga Institucioni vijnë nga pagesat e studentëve.

Në zërat shpenzime pjesën më të madhe e zënë shpenzimet për paga.

Gjatë vitit akademik 2015-2016 të ardhurat mesatare për student kanë qenë 1864 euro, ndërsa shpenzimet mesatare për student kanë qenë 1342 euro. Pra të ardhurat mesatare kanë mbuluar shpenzimet mesatare gjatë kësaj periudhe.

Të dhënat financiare janë në përgjigjësi për IAL dhe nuk kanë bërë analiza të vecanta për këtë program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Shoqëria “Turkut Ozal Education” sh.a kryen për cdo vit auditimin e jashtëm të situatës financiare. Raporti i Auditit paraqet situatën financiare për gjithë shoqërinë, por nuk ka një raport të vecantë për Universitetin “Epoka”.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj</p> <p>Brenda raportit të auditit janë specifikuar zërat në lidhje me grantet e huaja të fituara si dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë. Në dy vitet e fundit nuk janë siguruar të ardhura nga grantet dhe kontratat.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Drejtoria e përgjithshme e shoqërisë “Turgut Ozal Education” sha, harton një raport financiar brenda afateve të përcaktuara me ligj. Në raport përfshihen pasqyrat mbi të ardhurat dhe shpenzimet.</p> <p>Raportet financiare të tre viteve të fundit gjenden në Zyrën e Financës të Universitetit “Epoka”. Vërehet se zëri “shpenzime” është i lartë për shkak të ndërtimit të kampusit Universitar.</p> <p>Mbështetur në të dhënat financiare rezultojnë që të ardhurat mesatare për student janë më të larta se shpenzimet mesatare për student. IAL duhet të shohë me kujdes ecurinë e të gjitha programeve të studimit dhe të analizojë qëndrueshmërinë financiare në bazë fakulteti dhe jo vetëm si institucion në tërësi. Duke qenë pjesë e një shoqërie të madhe, Universiteti “Epoka” nuk paraqet probleme të qëndrueshmërisë financiare.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Universiteti “Epoka” auditohet çdo vit nga një kompani auditimi e pavaruar si pjesë e shoqërisë “Turgut Ozal Education” sh.a. IAL nuk ka raporte financiare të veçanta për çdo program studimi, apo cikël studimi. Bazuar në të dhënat e financiare dhe ecurinë e kompanisë, shpreh opinionin që IAL ka qëndrueshmëri financiare.</p> <p>Standardet e mësipërme përmbushen plotësisht.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Universitetit “ Epoka” ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në përputhje me kërkesat ligjore mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë si dhe në përputhje me dispozitatat e Statutit dhe të Rregullores të Universitetit “Epoka”.

Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë (KVAZHC) është organi qendror në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në Universitetin “Epoka”.

Numri i anëtarëve të KVAZHC-së përcaktohet nga Senati i Universitetit. Anëtarët e KVAZHC-së zgjidhen nga senati për një periudhë dy vjeçare. Kryetari i KVAZHC-së zgjidhet nga senati ndërmjet anëtarëve të Këshillit. Mbledhjet e

KVAZHC-së drejtohen nga kryetari dhe në mungesë të tij, Këshilli drejtohet nga pedagogu me titull shkencor më të lartë.

Në Universitetin “ Epoka”, KVAZHC është themeluar me Vendim NR. 2, datë 26.03. 2009 të Senatit dhe është riorganizuar me Vendimin nr. 1, datë 22.04.2013 të Senatit.

Sipas amendamenteve të miratuara nga Senati, KVAZHC përbëhet nga më së paku një anëtar i stafit akademik për çdo fakultet dhe me së paku gradën shkencore “Doktor” dhe që nuk ka detyra drejtuese, dy antarë nga stafi administrativ, Kryetari i Këshillit Studentor, një i diplomuar nga Universiteti “Epoka” si dhe një punëdhënës me përvojë të dalluar në treg.

NJSBC përbëhet nga 7 anëtarë. Përbërja e njësisë është në përputhje me amendamentet e miratuara nga Senati (Aneksi 3, Tabela 4)

Universiteti “Epoka” është pajisur me çertifikatën ISO 9001: 2008 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë. Aktualisht, Universiteti “Epoka” ndodhet në fazën e ripërtëritjes së kësaj çertifikate.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Të gjithë studentët e Universitetit “Epoka” plotësojnë nëpërmjet sistemit elektronik pyetësorë, me anë të të cilëve vlerësojnë modulën dhe pedagogun në përfundim të çdo semestri akademik. Përmbajtja e pyetësorëve është standarde dhe konsiston në vlerësimin nga ana e studentit të 14 treguesve në një interval nga 1 (vlerësim më i ulët) deri në 4 (vlerësimi më i lartë). Plotësimi i pyetësorit është konfidencial dhe i detyrueshëm për çdo student. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen nga sistemi, i cili ben dhe renditjen e pedagogëve.

Një metodë tjetër për të mbikqyrur cilësinë e mësimdhënies në Universitetin “Epoka” është dhe dëgjimi i shpjegimit të lëndëve në auditor nga Dekani apo Përgjegjësi përkatës i Departamentit. NJSBC luan rol të rëndësishëm në përgatitjen e dokumentave për vlerësimin e brendshëm të PS.

Universiteti “Epoka” harton në përfundim të çdo viti akademik një Raport Vetvlerësimi, të cilin ia paraqet Këshillit të Lartë të Universitetit. Universitetit “Epoka” ka hartuar Raporte të Vetvlerësimit edhe në kuadër të procesit të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit institucional si dhe të programeve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, në përputhje me kërkesat e Legjislacionit Shqiptar të Arsimit të Lartë. Të gjitha Raportet e Vlerësimit të Brendshëm janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit “Epoka”.



Grupi i Auditimit të Brendshëm zhvillon në mënyrë periodike seminare informuese dhe trajnuese me stafin e Institucionit në lidhje me përbërësit dhe rëndësinë që mbart Sigurimi i Cilësisë në përgjithësi dhe Cilësisë në veçanti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; 	<p>Universiteti “ Epoka” ka hartuar një metodologji për Vlerësimin e brendshëm dhe ka përcaktuar instrumentat matëse dhe vlerësuese për programin e studimit. Informacioni i mbledhur përmes pyetësotëve, raportet mbi mbikqyrjen e cilësisë së mësimdhënies, përfshihen në raportin e vetvlerësimit.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit i komunikohen stafit. Ato diskutohen edhe me studentët. Pas çdo rezultati të siguruar nga anketimi me studentët, bëhet rivlerësimi i brendisë së lëndës në bazë departamenti dhe dërgohet për miratim në Këshillin e Fakultetit e më pas në Senat</p> <p>Universiteti përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për të kryer vlerësimin e brendshëm.</p> <p>Metodat e tërthorta aplikohen me anë të anketës së zhvilluar me studentët ku ka seksione të veçanta mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmbajtjen e lëndës • Performancën e pedagogut të lëndës • Pyetje mbi shërbimin e ofruar nga Universiteti “Epoka” • Pyetje konceptuale • Rekomandime nga studentët <p>Metoda të drejtpërdrejta janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjime në auditor të leksionit • Rezultat e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara • Nota mesatare për çdo student dhe krahasimi me atë të shkollës së mesme • Vlerësimi me pikë për aktivizimin në auditor • Vlerësimi i detyrave të kryera. • Vlerësimi për përfshirjen në aktivitete jashtë shkollore

<p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	
<p>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</p> <p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>	<p>Universiteti “Epoka” i ka plotësuar standardet e akreditimit në nivel institucional.</p> <p>Institucioni është akredituar me Urdhër Nr 260, datë 07.06.2011, dhe me këtë urdhër është akredituar edhe programi i studimit si; “ <i>Bachelor në Ekonomik</i>”, (me kohëzgjatje normale 4 vite akademike)</p> <p>Ky program studimi është riorganizuar nga Bsc (4 vjeçar) në Bsc (3 vjeçar) me Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012 mbështetur në (VKA Nr. 342, datë 13.07.2012) Vendimi i parë për riorganizimin: VKA Nr. 313, datë 16.03.2012.</p> <p>Në vizitën e GVJ, Institucioni argumentoi se në Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 312, datë 27.07.2012, në lidhje me ri-organizimin e programit të studimit në fjalë, nuk ishte parashikuar ndonjë dispozitë që kërkon ri-akreditimin e programit të studimit.</p> <p><i>Ky është akreditimi i parë pas riorganizimit të PS.</i></p> <p>Nga takimi me grupin e NJSBC dhe informacionin e marrë mbi punën që kryen, konstatova që IAL i jep mëshjetjen dhe mjetet e nevojshme kësaj njësie për të krijuar të gjitha instrumentat për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Universiteti “Epoka” ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programit.</p> <p>IAL ka krijuar mekanizma formal për miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të PS, si pjesëmarrja në leksionet e hapura, përdorimin e pyetësorëve për të vlerësuar elementë të mësimdhënies dhe pedagogët, standartizimin e leksioneve në PPP, etj</p> <p>Ndërgjegjësimi për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e saj adresohet jo vetëm nga NJSBC, por dhe nga të gjitha mekanizmat e krijuara. Për këtë janë vënë në dispozicion guida Studentore dhe guida e stafit, ku shprehet rëndësia e cilësisë dhe</p>



<p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>sigurimi i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Gjithashtu, janë krijuar dhe disa trajnime periodike për stafin si dhe këshillimi i vazhdueshëm i studentëve nga këshilltarët e tyre akademik.</p> <p>Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar në planin strategjik të zhvillimit.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Universiteti “Epoka” i ka plotësuar standardet e akreditimit në nivel institucional. Akreditimi i plotë institucional është marrë me Urdhër Nr 260, datë 07.06.2011, dhe me këtë Urdhër është marrë dhe akreditimi i programit të studimit “ Bachelor në Ekonomik (me kohëzgjatje normale 4 vite akademike)”. Ky program studimi është riorganizuar nga Bsc (4 vjeçar) në Bsc (3 vjeçar) me Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012 mbështetur në (VKA Nr. 342, datë 13.07.2012) Vendimi i parë për riorganizimin: VKA Nr. 313, datë 16.03.2012. <i>Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 312, datë 27.07.2012, në lidhje me riorganizimin e programit të studimit në fjalë, nuk përmban ndonjë dispozitë që kërkon ri-akreditimin e programit të studimit. Ky është akreditimi i parë pas riorganizimit të PS.</i> GVJ konstatoi se IAL-ja ka një ndjeshmëri të lartë në drejtim të sigurimit të cilësisë të programeve të studimit, ka të formalizuara metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse të paanshëm dhe objektiv për vlerësimin e brendshëm.</p> <p>Standartet e mësipërme përmbushen plotësisht.</p>	


POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Programi i studimit “ Bachelor në Ekonomiks” në Universitetin “Epoka” është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 176, datë 07.06.2011, si Bachelor në Ekonomik (me kohëzgjatje normale 4 vite) . Ky program studimi ka si qëllim kryesor edukimin dhe përgatitjen e individëve të kualifikuar për t’i shërbyer dhe për të përmbushur nevojat e tregut të punës në mënyrën më të mirë të mundshme. Duke patur parasysh përpjekjet e mëdha për Integrimin e Shqipërisë në Europë, kërkesat e tregut të punës për individë të kualifikuar dhe të aftë konsiderohen të larta.

Duke ndjekur këtë program studimi studentët familjarizohen me çështje të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, pasi programi i ekonomiksit



është strukturuar rreth një grupi kursesh teknike, që i ekspozon studentët me njohuritë themelore të metodave sasiore teorive ekonomike dhe aplikimit të tyre. Aftësitë e fituara në këtë program studimi i përgatit studentët për të vazhduar më tej punën në institucionet publike dhe ato private. Ata mund të punësohen si drejtues, specialistë apo këshilltarë në administratën publike për fushën e ekonomisë, specialistë ose drejtues në organizata jofitimprurëse, etj.

Objektivat e Programit “Bachelor” në Ekonomiks janë:

- Përvetësimi i koncepteve bazë në lidhje me fushën e ekonomiksit dhe përdorimi i tyre me efikasitet
- Integrimi i teorikës, praktikës dhe politikave të ndryshme në mënyrë që studentët të kuptojnë mënyrën e funksionimit të politikave ekonomike
- Krijimi i parakushteve për zhvillim të vazhdueshëm si rezultat i ofrimit të programeve shumë cilësore dhe konkurente në tregun e dijes.
- Ndërgjegjësimi i studentëve për të kontribuar për komunitetin
- Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi me të mësuarit gjatë gjithë jetës në mënyrë që t'i përshtaten tregut të punës.
- Përcjellja e trendeve në fushën e shkencës dhe praktikës së ekonomisë
- Përgatitja e kuadrove në fushat e ndryshme të ekonomisë në Shqipëri, rajon dhe më gjerë.
- Përgatitja e liderve me formim të thelluar shkencor në fushën e drejtimit, ekonomisë, zhvillimit të burimeve njerësore, sjelljes organizative dhe kërkimit shkencor
- Përgatitja e specialistëve në fushën e ekonomisë në vend.

Programi i studimit “Bachelor” në Ekonomiks është program studimi me kohë të plotë. Ky program realizohet me 180 ECTS në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Ekonomiksit, me vendim të Këshillit të Fakultetit dhe miratuar me Vendim të Senatit Akademik të Universitetit “Epoka” . Programi i studimit është organizuar në tre vite akademike, 6 semestra dhe 16 javë mësimore për çdo semestër në auditor (këtu përfshihet dhe java e provimit)

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor (këtu përfshihet dhe java e provimit)

- 1 semestër ka 16 javë mësimore në auditor (këtu përfshihet dhe java e provimit mid term)
- 1 ETCS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore ka 60 minuta

Studentët që përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara nga programi Bachelor në Ekonomiks, pajisen me diplomë “ Bachelor në Ekonomiks”

Cdo lëndë ka një fond orësh që ndahet në Orë Auditor dhe orë punë e pavarur që në total janë 125 orë. Për vitin akademik 2015-2016 u realizuan 1888 orë leksione dhe 2615 orë punë e pavarur nga studenti.

Në planin mësimor në më të shumtën modulet janë vlerësuar 5 ECTS, por ka dhe lëndë me 6 ETCS dhe si **formë mësimdhënie është parashikuar vetëm leksioni.**

Përcaktimi i krediteve (ECTS) për format e studimit.

- Për leksionet 1 ECTS 12 orë në auditor dhe 12-15 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 10 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit

Modulet në planin mësimor janë paraqitur edhe sipas veprimtarisë formuse (A-F)

- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A) 30 ECTS
- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B) 88 ECTS
- Veprimtari në disiplina të formimit të ngjashme (C) 20 ECTS
- Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D) 11 ECTS
- Njohuri të tjera formuese si plotëime në gjuhë të huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E) 25 ECTS
- Teza e diplomës (F) 6 ECTS

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara janë në (Tabelën 5, Aneksi 5)

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës nuk kanë ndryshime me ato të përgatitura nga GVB.

Syllabuset i kanë të gjitha elementët. Ato janë të standartizuara për të gjitha modulet.

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion është lista e plotë e lektorëve, lista e moduleve gjatë vitit akademik 2015-2016

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Ekonomiks” që ofron Institucioni, është i akredituar, me Urdhërin Nr 260, datë 07.06.2011, si Bachelor në Ekonomik (me kohëzgjatje normale 4 vite akademike) Ky program studimi është riorganizuar nga Bsc (4 vjeçar) në Bsc (3 vjeçar) me Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012 mbështetur në (VKA Nr. 342, datë 13.07.2012) Vendimi i parë për riorganizimin është VKA Nr. 313, datë 16.03.2012.</p> <p>Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 312, datë 27.07.2012, në lidhje me riorganizimin e programit të studimit në fjalë, nuk përmban ndonjë dispozitë që kërkon riakreditimin e programit të studimit. Ky është akreditimi i parë pas riorganizimit.</p> <p>Programi është organizuar në module, të cilat janë vlerësuar me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Plani mësimor i këtij programi parashikon ngarkesën me 180 kredite të shpërndara në gjashtë semestra. Sasia mesatare e krediteve që grumbullohet gjatë një viti është 60 kredite.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e</p>	<p>Studentëve iu ofrohet informacion në lidhje me programin e studimit që në fillim të procesit mësimor. Studentëve iu vihet në dispozicion plani mësimor dhe programet e lëndëve, të cilat mund të gjendet tek “Guida e studentit” dhe në versionin online në faqen e internetit të Universitetit “Epoka”.</p> <p>Departamenti jep informacionin e nevojshëm për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër. Cdo klasë ka një këshillues akademik, i cili informon studentët për lëndët me zgjedhje dhe aprovon lëndët e zgjedhura nga studentit.</p> <p>Njësitë kryesore, përgjegjëse për programin e studimi, japin informacionet e nevojshme për</p>

detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj, të cilat gjenden të publikuar edhe në ëbsite-in e Universitetit.
([http://eis."Epoka".edu.al](http://eis.))

Konkluzionet e GVJ:

Ky program studimi është riorganizuar nga Bsc (4 vjeçar) në Bsc (3 vjeçar) me Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012 mbështetur në VKA Nr. 342, datë 13.07.2012 Vendimi i parë për riorganizimin: VKA Nr. 313, datë 16.03.2012. Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 312, datë 27.07.2012, në lidhje me ri-organizmin e programit të studimit në fjalë, nuk përmban ndonjë dispozitë që kërkon ri-akreditimin e programit të studimit. Kjo është hera e parë e akreditimit pas riorganizimit të Programit të studimit

Programi i studimit "Bachelor" në Ekonomiks realizohet me 180 kredite. Ka kohëzgjatje 3 vite akademike. Kohëzgjata dhe numri i krediteve është në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, " Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

IAL ofron informacion të plotë dhe të detajuar dhe të aksesueshëm në lidhje me programet e studimit, lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër, praktikat, ushtrimet, etj.

Standardet e mësipërme që lidhen me programin e studimit përmbushen plotësisht.

8. Mësimdhënia

Programi i studimit "Bachelor në Ekonomiks" është me kohë të plotë, tre vite akademike dhe 6-semestra dhe i vlerësuar me 180 kredite. Afati maksimal i studimit është sa dyfishi i periudhës normale të studimit (6 vjet)

Viti akademik përbëhet nga semestri i vjeshtës dhe semestri i pranvesrës.

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njesisë etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Format e organizimit të mësimdhënies janë leksionet, projektet, detyrat e kursit dhe punime të parashikuara në programin mësimor, sipas rregullores së këtij programi studimi. Sipas të shënave të planit mësimor, syllabuseve dhe takimit me stafin dhe studentët, mësimdhënia realizohet kryesisht me leksione të ndërthurura me elementë seminari sipas Sistemit Amerikan. Në

këtë program nuk janë të parashikuara praktikat profesionale. Ngarkesa mësimore është 16 javë mësimore duke përfshirë dhe javën e provimit.

Kontrolli i dijeve të studentëve realizohet bazuar në disa elementë si: ndjekja e moduleve dhe pjesëmarrja aktive në leksion, provimi i pjesshëm, detyra kursi, projekte, provim përfundimtar. Pedagogët kanë liri akademike të përcaktojnë mënyrat dhe format e kontrollit, të cilat janë pjesë e syllabus-it. Elementët e kontrollit ndryshojnë sipas specifikave që kanë lëndët/modulet.

Format e kontrollit dhe formula e vlerësimit të studentit për cdo lëndë, është pjesë e syllabus-it të lëndëve. Në fillim të cdo semestri pedagogët u bëjnë të ditur të studentëve modelin dhe formulën e zgjedhur për vlerësimin e njohurive të tyre përgjatë semestrit dhe në fund të tij. Syllabuset e lëndëve janë në faqen e internetit dhe mund të konsultohen lirisht nga studentët.

Provimi final zë 40% notës përfundimtare. Tezat e provimit hartohet nga titullari i lëndës sipas një formati të hartuar nga IAL. Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet me shkrim dhe i sekretuar, duke siguruar në këtë mënyrë objektivitetin e vlerësimit.

Dhënia e njohurive të reja bëhet duke përdorur mjete audiovizive për ta bërë leksionin sa më tërheqës, por pedagogët operojnë gjithashtu dhe me materialet në PPP në varësi të modulit. Të gjitha materialet ngarkohen nga pedadogu në sistem, i cili iu mundëson studentëve aksesin në leksion kudo që janë dhe kanë mundësi interneti. Pedagogët e lëndës i azhurnojnë në mënyrë periodike leksionet dhe materialet që kanë lidhje me lëndën.

Kontrolli i cilësisë në mësimdhënie realizohet nga departamenti dhe NJSBC. Departamenti i Ekonomiksit diskuton ndryshimet e mundshme në syllabus në fillim të semestrit. Nëse ka ndryshime ato miratohen nga departamenti, së bashku me materialet mësimore dhe ndihmëse në funksion të realizimit të programit. Të gjithë pedagogët kanë detyrimin që të përgatisin “dosjen e lëndës”, e cila përfshin të gjitha materialet dhe leksionet e shpjeguara gjatë semestrit, një kopje shembull të provimeve të zhvilluara, një kopje të provimit më të mirë dhe më të dobët, etj. Departamenti analizon të dhënat e kontrolleve dhe anketimevetë zhvilluara me studentët për të vlerësuar format e mësimdhënies, cilësinë e mësimdhënies nga ana e pedagogut, objektivin e

vlerësimit, etj. Rezultatet e vlerësimit përshihen në raportin vjetor të departamentit.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë:

- Për punime shkencore individuale të pedagogëve 30 studentë
- Për projekte shkencore në rang Departamenti 38 studentë
- Për projekte shkencore në rang Fakulteti 90 studentë

9. Studentët

Universiteti “Epoka” ka miratuar procedurat e Pranimit për studentët në këtë PS. Kriteret kalasifikohen si kriteret të përgjithshme dhe kriteret specifike. Në Programin e studimit “Bachelor në Ekonomiks” kanë të drejtë për t’u pranuar:

- Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar me sukses Maturën Shtetërore si dhe plotësojnë kriteret specifike të pranimit nga Universiteti “ Epoka”;
- Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar me sukses provimet parauniversitare jashtë Shqipërisë dhe disponojnë vërtetimin e njësisimit të kësaj diplome lëshuar nga MAS si dhe plotësojnë kriteret specifike të pranimit nga Universiteti “ Epoka”
- Shtetasit e huaj, kuota e të cilëve përcaktohet çdo vit, që kanë përfunduar studimet parauniversitare jashtë Shqipërisë dhe disponojnë vërtetimin e njësisimit të kësaj diplom të lëshuar nga MAS si dhe plotësojnë kriteret specifike të pranimit nga Universiteti “Epoka”.

Në kushtet specifike të pranimit në këtë PS janë:

- Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme të jetë jo më pak se 7-të për të gjitha programet e ofruara në gjuhën angleze
- Njohja e gjuhës angleze. Gjuha duhet të jetë e vërtetuar me një certifikatë që njihet nga MAS ose provimi i mjaftueshmërisë së gjuhës angleze i Universitetit “ Epoka”

Studentët që plotësojnë kriteret rregjistrohen nga IAL sipas Udhëimit Nr. 17, datë 31.07.2012 “Për procedurën e pranimit dhe rregjistrimit në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve me kohë të plotë të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë Privat si dhe për transferimin e studimeve për vitet akademike respective. Studentët që plotësojnë kriteret e pranimit mund të rregjistrohen dhe

të lidhin kontratën e rregjistrimit, pasi studenti ka dorëzuar dokumentacionin që kërkohet sipas udhëzimit.

Kriteret e pranimit për të gjitha PS janë të shpalluar nga Universiteti “Epoka”. Numri i studentëve të pranuar në këtë program studimi ka ardhur duke u rritur, nga 8 studentë në vitin akademik 2012 -2013, në 31 studentë në vitin akademik 2016 – 2017 dhe parashokohen nga IAL 40 studentë për vitin akademik 2017-2018. Megjithatë, mendoj se është një numër relativisht jo i lartë studentësh. Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Numri i studentëve për Bsc në Ekonomiks		
Viti akademik	Studentë të rregjistruar për herë të parë	Nota mesatare
2012 - 2013	8	9.09
2013 - 2014	22	8.82
2014 - 2015	30	9.22
2015 - 2016	20	9.17
2016 - 2017	31	8.77

Numri i studentëve të diplomuar në këtë PS për periudhën 2012 – 2016 është 39 studentë. Nota mesatare në hyrje ka qenë mbi 8.80. Në Universitetin “Epoka”, studentët vlerësohen sipas sistemit Amerikan të bazuar në notën maksimale 4.00. Nota më e ulët kaluese për këtë PS është 1.00-4.00.

Notat mesatare në dalje janë llogaritur për vitet 2015 (3.47) dhe për vitin akademik 2016 (2.78)

Në këtë program studimi ka gjithsej 9 studentë të transferuar nga Universitetet e tjera brënda dhe jashtë vëndit në Universitetin “Epoka”. Mënyrat dhe kushtet e transferimit të studentëve parashikohen në rregulloren “Për transferime horizontale mes IAL-ve në nivel Parauniversitar dhe Universitar”.

Universiteti “Epoka” ka themeluar Qendrën e Planifikimit të Karrierës, e cila e kryen veprimtarinë e saj në kuadër të zyrës së planifikimit të karrierës dhe studentëve të Diplomuar. Qendra orienton studentët në procesin e zhvillimit të ardhshëm dhe ndërmjetëson komunikimin ndërmjet studentëve dhe institucioneve apo kompanive të ndryshme me qëllim punësimin e studentëve të diplomuar.

Ndër fushat kryesore të saj është dhe organizimi i programeve të praktikës si dhe organizimi i trajnimeve për studentët e Universitetit “Epoka”, për t’i pajisur ata më mirë me aftësitë e nevojshme që do t’i ndihmojnë në karrierën e ardhshme profesionale. Qendra merret dhe me organizimin e Panairëve të Punës.

Universiteti “Epoka” ka hapur dhe Zyrën e të Diplomuarve (Alumni Office), e cila stimulon interesin dhe pjesëmarrjen e të diplomuarve në jetën e Universitetit, duke i përfshirë ata në aktivitete dhe projekte të përbahkëta.

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 37 dhe 2 numri total i të punësuarve jo në përputhje me diplomën.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Univeriteti “Epoka” përcakton gjuhën e huaj dhe mesataren si kritere specifike. Më këtë PS mesatarja e shkollës së mesme duhet të jetë mbi 7.00. Nga Vizita në IAL mësuam që niveli i anglishtes të disa prej studentëve nuk është shumë i mirë. Megjithatë, institucioni ofron kurse intensive të gjuhës angleze, në mënyrë që studentët të arrijnë nivelin e kërkuar të anglishtes nga Universiteti Epoka.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p>	<p>Sekretaria mësimore dhe personeli akademik informon në mënyrë të vazhdueshme studentët për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit. Ky program gjendet i plotë dhe në faqen e internetit të IAL.</p> <p>Studentët e kanë të detyrueshme të plotësojnë vlerësimin e pedagogut të cdo lënde/moduli. Plotësimi bëhet në mënyrë elektronike dhe ruhet privatësia e cdo studenti.</p> <p>Universiteti “Epoka” ka themeluar Qendrën e Planifikimit të Karrierës, e cila e kryen veprimtarinë e saj në kuadër të</p>

<p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>zyrës së planifikimit të karrierës dhe studentëve të Diplomuar. Qendra orienton studentët në procesin e zhvillimit të ardhshëm dhe ndërmjetëson komunikimin ndërmjet studentëve dhe institucioneve apo kompanive të ndryshme me qëllim punësimin e studentëve të diplomuar.</p> <p>Ndër fushat kryesore të saj është dhe organizimi i programeve të praktikës si dhe organizimi i trajnimeve për studentët e Universitetit “Epoka”, për t’i pajisur ata më mirë me aftësitë e nevojshme që do t’i ndohmojnë në karrierën e ardhshme profesionale. Qendra merret dhe me organizimin e Panaireve të Punës.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Sekretaria mësimore disponon të dhëna statistikore për numrin e të diplomuarve në bazë vitit akademik. Zyra e karrierës na vuri në dispozicion numrin e të diplomuarve që kishin mbaruar këtë PS. Numri i studentëve të diplomuar në këtë PS për periudhën 2012 – 2016 është 39 studentë.</p> <p>Sekretaria mësimore disponon statistika vjetore që nevojiten për përmbushjen e këtij kriteri. Sistemi i Informacionit për çështjet e studentëve ka të dhëna dhe gjeneron raporte statistikore për të gjithë kategoritë e studentëve.</p> <p>Sekretaria mësimore si dhe sekretaria e departamenteve disponojnë të dhëna të ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të çdo student gjatë zhvillimit të programit mësimor (notat e provimeve, frekuentimin, etj). Të dhënat ruhen në formë elektronike dhe rregjistra</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës që operon pranë Dekanatit të Studentëve iu ofron shërbimin e këshillimit studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon në trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave që lidhen me procesin mësimor.</p> <p>Në këtë program studimi nuk parashikohet kryerja e praktikës profesionale.</p>

Konkluzionet e GVJ

Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.

Universiteti "Epoka" përcakton kritere të përgjithshme dhe specifike për pranimin e studenëve në programin e studimit Bachelor në "Ekonomiks" sipas rregullave në fuqi. IAL informonte studentët në lidhje me programin e studimit që ofron dhe me politikën e punësimit të studentëve.

Nga Vizita në IAL mësuam që niveli i anglishtes të disa prej studentëve nuk është shumë i mirë. Megjithatë, institucioni ofron kurse intensive të gjuhës angleze, në mënyrë që studentët të arrijnë nivelin e kërkuar të anglishtes nga Universiteti Epoka.

IAL disponon statistika për numrin e studentëve që ndjekin këtë PS dhe numrin e studentëve të punësuar pas diplomimit.

Studentëve iu ofrohet shërbimi i Këshillimit të Karrierës.

IAL disponon të dhëna të ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të çdo studenti gjatë zhvillimit të programit mësimor. Të dhënat ruhen në formë elektronike dhe rregjistra.

Institucioni ndjek politikën e Informimit të vazhdueshëm të studentit për programet dhe afatet e përfundimit të moduleve, por edhe të vlerësimit të tyre gjatë dhe në përfundim të programit. Zyra e Këshillimit të Karrierës iu ofron shërbimin e këshillimit studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon në trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave që lidhen me procesin mësimor.

Ky standard përmbushet plotësisht

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Universiteti "Epoka" është një Institucion që krahas mësimdhënies e ka orientuar veprimtarinë e vet dhe nga kërkimi shkencor. IAL e inkurajon stafin akademik për të zhvilluar punë kërkimore shkencore dhe ofron mbështetjen financiare për realizimin e saj. Publikimet e stafit vlerësohen nga një juri e posaçme një herë në vit në bazë të kritereve të përcaktuara në "Rregulloren për Nxjitjen e Publikimeve Shkencore". Universiteti ofron gjithashtu mbështetjen financiare për realizimin e projekteve shkencore, pjesëmarrjen e stafit në konferenca dhe veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit. Universiteti ofron një "grant" për çdo pedagog për kërkimin shkencor, i cili përfitohet sipas një vlerësimi me pikë që Institucioni ka krijuar. Megjithatë, mendoj se nuk është e mjaftueshme dhe duhet të rritet mbështetja financiare për pjesëmarrjen e stafit në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, stafi duhet të intensifikojë përpjekjet për të siguruar mbështetje nga burime të jashtme për

zbatimin e projekteve kërkimore. Në kuadër të punës shkencore IAL dhe Departamenti që mbulon programin e studimit realizojnë konferenca shkencore. Politikat e kërkimit shkencor të përmendura më sipër janë të vlefshme për të gjitha PS-të.

Puna kërkimore shkencore është orientuar kryesisht:

- Në rritjen e nivelit të mësimdhënies
- Kualifikimin shkencor të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit dhe përfshirja e tyre sa më e gjerë në projekte të ndryshme kërkimore të financuara nga IAL dhe financime nga projektet ndërkombëtare.
- Formimi teoriko – profesional i studentëve në përgjigje të kërkesave të tregut të punës dhe stimulimit të prirjeve individuale të studentëve në fushën të ndryhme.
- Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit të IAL me universitete të huaja dhe vendase.

Gjatë vizitës në IAL u verifikuan të gjitha të dhënat në lidhje me kërkimin shkencor dhe të deklaruara nga RVB. Nga verifikimi u konstatua që nuk ka ndryshime. Një pjesë e madhe e informacionit mbi publikimet, projektet, konferencat, mund të aksesohen përmes faqes së internetit të Universitetit “Epoka”.

Të dhënat për kërkimet shkencore për periudhën 2012- 2016 janë:

1. Numri i botimeve nga personeli akademik i Fakultetit të Shkencave ekonomike dhe Administrative (149)
2. Numri i botime shkencore i stafit akademik të Ekonomiksit (75)
3. Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL (9)
4. Numri i projekteve kërkimore të fituara (15)
5. Numri i projekteve të zbatuara (8)
6. Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL (85)
7. Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor (-)
8. Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor (4)
9. Numri i Çmimeve Kombëtare (6)

Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

Gjatë vizitës në IAL u morr “Revista shkencore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative”. Gjithashtu u kërkua pjesëmarrja e



studenteve në konferenca dhe IAL vendosi në dispozicion pjesëmarrjen në konferencën më të fundit, ku studentë në bashkëpunim me pedagogë kryen studimin më të fundit: “ Perceptimi i gjimnazistëve për fushën e studimit të Ekonomiksit”

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Universiteti “Epoka” në veprimtarinë e tij i ka kushtuar një vëmendje të vecantë bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Universiteti bashkëpunon me Institucione arsimore dhe kërkimore, Institucione publike, korporata kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me sipërmarrje të ndryshme private.


Bashkëpunimi me IAL publike dhe private ka synuar kryesisht shëmbimin e programeve dhe planeve mësimore, shkëmbimin e stafit dhe studentëve, organizimin e konferencave të përbashkëta dhe zhvillimin e kërkimit shkencor. Të gjitha bashkëpunimet janë të dokumentuara përmes marrëveshjeve dhe protokolleve të bashkëpunimit. Universiteti “Epoka” ka marrëveshje me IAL publike dhe private që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri, në rajonin e Ballkanit, Vendet e Europës Perëndimore dhe IAL në SHBA.

Numri i madh i marrëveshjeve është për Universitetin “Epoka” në tërësi dhe jo në mënyrë të vecantë për këtë program studimi.

Universiteti ka krijuar “Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare” për ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtare. Misioni dhe veprimtaria e zyrës është e mirëpërcaktuar në Rregulloren e Brendhme të IAL.

IAL ka ndërtuar partneritete të qëndrueshme me komunitetin e biznesit. Qëllimi i këtyre partneriteteve është të mundësojnë realizimin e praktikave profesionale/verore të studentëve pranë këtyre bizneseve. Gjatë vizitës në IAL u konstatua që të dhënat e deklaruara nga RVB për treguesit e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar janë korrekte dhe nuk ka ndryshime.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



Të dhënat sasiore për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar janë:

1. Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo Ndërkombëtare **(11)**
2. Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj për vitin akademik 2015-2016 **(13)**
3. Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit (-)
4. Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL për vitin akademik 2015-2016 **(22 të ardhur në IAL/ 6 studentë të larguar nga IAL)**
5. Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor:
 - IAL ka buxhet të vecantë vjetor për pjesëmarrjen në konferenca
 - Buxhet për blerjen e librave të rinj dhe revistave ka rreth (7000 libra)
 - Fonde për marrjen e të drejtës së përdorimit të bibliotekave online (6 librari online). Aktualisht IAL ka abonim në bibliotekën online JSTOR.
6. Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime **(277)**

Universiteti “Epoka” ka 38 marrëveshje bashkëpunimi dhe/ose protokolle me IAL dhe Institucione kerkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me disa Universitete në rajonin e Ballkanit, vende anëtare të BE-së dhe SHBA-së. Universiteti “Epoka” ka 6 marrëveshje në kuadrin e Programit Erasmus +. Programet e shkëmimit i krijojnë mundësi stafit akademik të kryejnë programin e shkëmbimit nga 5 ditë deri në 1 muaj. Në kuadrin e këtij projekti, janë bërë pjesë e Programit 7 anëtarë të stafit akademik. Marrëveshjet nuk janë vetëm për këtë Program Studimi. IAL është e anëtarësuar në 6 Organizata ndërkombëtare. Institucionet qeveritare bashkëpunuese të IAL-së janë INSTAT, AIDA, Drejtoria e Tatimeve, etj.

Dokumentacioni përkatës. Shembuj të marrëveshjeve me Institucione të ndryshme në lidhje me praktikat profesionale. (Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Universitetit “Epoka” dhe INSTAT.

Në faqen e Internetit të Universitetit “Epoka” jepen informacione mbi marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Universiteti “Epoka” ka nxitur bashkëpunimin e efektshëm ndërmjet personelit mësimdhënës dhe atij administrativ. Gjatë vizitës u konstatua një klimë pozitive, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ndërmjet personelit të Departamentit të

Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

Ekonomiksit dhe stafit mbështetës. Universiteti "Epoka" ka ndarje të qartë të detyrave sipas vendeve të punës dhe përshkrimi i punës orienton secilin punonjës të që të kryejë detyrat që i takojnë.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Aktualisht IAL ka dhjetra Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja në vendet e Ballkanit, vende të BE-së dhe SHBA-së, me IAL publike në Shqipëri, Institucione kërkimore dhe komunitetin e biznesit. Shumë nga këto marrëveshje ndihmojnë IAL për të arritur objektivat në këtë PS. IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë kompani për kryerjen dhe mbikëqyrjen profesionale. Pjesa më e madhe e tyre janë të përshtatshme për kryerjen e praktikave profesionale nga studentët e këtij PS. Praktikave të studentëve kryeshin gjatë sezonit të verës, ku studentët aplikojnë individualisht me mbështetjen e Zyrës së Karrierës, në Institucionet publike, si dhe në kompani private, brenda dhe jashtë vendit. Kryerja e praktikave nuk është detyruese dhe nuk përfshihet në PS. Nga RVB dhe nga vizita në IAL nuk konstatuam që të organizohen trajnime të mëtejshme profesionale me studentët e këtij PS. IAL bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale, ku rezultoi se Universiteti ka kryer shkëmbimin e 65 studentëve, të cilët kanë kryer një apo dy semestra në Universitetet partnere.

Konkluzionet e GVJ

Nga takimi i organizuar me stafin me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme u konstatua se klima e punës në IAL ishte bashkëpunuese dhe mbështetëse. Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e tjera homologe, brenda dhe jashtë vendit si dhe me bizneset vendase. IAL ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Institucione si; INSTAT, Drejtoria e Tatimeve, etj dhe kompanitë e biznesit, që mundësojnë kryerjen e praktikave të studentëve për këtë PS.

IAL përmbush standartet që lidhen me bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Përfundim: Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në Institucion vlerësoj që Universiteti "EPOKA" i ka plotësuar rekomandimet e vendosura në VKA Nr. 176 , datë 30.05.2011, për programin e studimit Bsc në "Ekonomiks".


ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Plani mësimor i programit të Studimit "Bachelor në Ekonomiks" respekton standardet bashkohore të programeve të ciklit të parë të studimeve.
- 2) Tregues cilësor të personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm që garantojnë përmbushje të qëllimeve të programeve të studimeve
- 3) Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe të fushave të tjera në funksion të zhvillimit të Institucionit dhe të realizimit të PS.
- 4) Personel drejtues që menaxhon në mënyrë të efektshme Institucionin dhe PS
- 5) Infrastrukturë bashkëkohore, kushte moderne për zhvillimin e procesit mësimor si dhe hapësira të mëdha të gjelbra në kampusin Universitar.
- 6) Abonimi i Universitetit në baza të ndryshme të dhënash të bibliotekave ekelektronike.

b. Pika të dobëta:

- 1) IAL duhet të shohë me kujdes ecurinë e të gjitha programeve të studimit dhe të analizojë qëndrueshmërinë financiare në bazë fakulteti dhe jo vetëm si institucion në tërësi.
- 2) Drejtimi i Universitetit i duhet të përballlet me një staf me botëkuptime të ndryshme shoqërore.
- 3) Pjesëmarrja e stafit në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare nuk mbështetet mjaftueshëm nga ana financiare.
- 4) Njohuri të pamjaftueshme së gjuhës angleze nga ana e disa prej studentëve.



- 5) Pjesëmarrje e kufizuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 6) Stafit duhet të intensifikojë përpjekjet për të siguruar mbështetjen nga burime të jashtme për zbatimin e projekteve kërkimore.
- 7) Sfida për të tërhequr më shumë studentë, pasi numri aktual i studentëve është relativisht jo i lartë.
- 8) Mungesë e promovimit të mjaftueshëm të Universitetit ndaj publikut të gjerë dhe grupeve të synuara.
- 9) Mosnjohja e gjuhës shqipe nga ana e stafit të huaj sjell kufizim të ndjekjes së ecures së çështjeve shoqërore dhe ekonomike në vend.
- 10) Kryerja e pjesës më të madhe të proceseve dhe operacioneve të punës në më shumë se një gjuhë dhe në pjesën më të madhe në gjuhë joamtare sjell vështirësi për stafin e Institucionit.

c. Mundësitë:

- 1) Mundësi për të thithur më shumë gjimnazistë, pas vendosjes së anglishtes si provim i detyrueshëm më maturën shtetërore apo dhe hapja e Programeve të studimit në gjuhën shqipe.
- 2) Bashkëpunim me Institucione të tjera vendase si BSH, etj
- 3) Marrëveshjet e bashkëpunimit me IAL të huaja për kualifikimin e stafit
- 4) Implementimi i mëtejshëm i mobilitetit të stafit dhe studentëve në kuadrin e projektit Erasmus + dhe Horizon 2020.
- 5) Rritja e interesit të shoqërisë në të mësuarin e vazhdueshëm
- 6) Zhvillimi i infrastrukturës të të mësuarit online.
- 7) Përmirësimi i imazhit të Universitetit me orientim kërkimi.

d. Pengesat:

- 1) Kriza ekonomike dhe rënia e të ardhurave për ekonomitë familjare
- 2) Konkurenca nga IAL publike që ofrojnë programe të ngjashme.
- 3) Mungesa e fondeve për financimin e studimeve me anë të bursave
- 4) Ndryshimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe nënligjor i Arsimit të Lartë
- 5) Konkurenca jo e drejtë e Arsimit të lartë në Shqipëri.



**SUMMARY ANALYSIS OF EXTERNAL EVALUATION REPORT (EER)
ACCORDING TO SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities and Threats)
METHOD**

a. Strengths:

- 1) The Curriculum of "Bachelor in Economics" study program fulfills the contemporary standards of the first cycle of studies.
- 2) Qualitative indicators of internal and external academic staff that guarantee the fulfillment of the objectives of the study program.
- 3) Cooperation agreements with educational Institutions and institutions from other fields that enable institution development and realization of the study program.
- 4) Managing staff that effectively manages the Institution and the study program.
- 5) Contemporary infrastructure, modern facilities for carrying out the teaching process, as well as large green spaces on the University campus.
- 6) Subscription of the University on various databases of electronic libraries.

b. Weaknesses:

- 1) "Epoka" University should carefully analyze the progress of all study programs and financial sustainability on a faculty basis and not just as a whole institution.
- 2) Managerial Challenges due to cultural diversity of University staff.
- 3) Limited financial support for the development of scientific research and participation in other scientific conferences and seminars.
- 4) Low level of knowledge of English language by a part of students.
- 5) Limited participation in National and International projects.
- 6) Staff should intensify efforts to provide support from external sources for the implementation of research projects.
- 7) The challenge to attract more students, as the actual number of students is relatively low.
- 8) Lack of sufficient promotion of University towards the general public and the target groups.
- 9) Lack of knowledge of Albanian language by a part of foreign staff regarding the regular follow-up of social, economic and political developments in the country.



- 10) Conducting most of the processes and work operations in more than one language and largely in non-native languages causes difficulties for the staff of the Institution.

c. Oppotunities:

- 1) Potentials to attract more high school students as English language is set a compulsory state exam and the opening of study programs in Albanian language.
- 2) Collaboration with other local institutions such as Bank of Albania, etc.
- 3) Cooperation Agreements with Foreign Universities for staff qualification.
- 4) Further implementation of staff and student mobility within the framework of the Erasmus + and Horizon 2020 project.
- 5) Increasing interest of the society in Continuous Learning.
- 6) Development of online learning infrastructure.
- 7) Improvement on the research oriented image of the University.

d. Threats:

- 1) The economic crisis and the decline of income of households.
- 2) Competition from public Institutions of Higher Education that offer similar programs.
- 3) Lack of funds for financing studies through scholarships.
- 4) Continuous change of the legal and sub-legal framework of Higher Education.
- 5) The Unfair Competition in Higher Education system in Albania.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asc.Dr. Brunilda DURAJ

